



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 26.11.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve 1 dhe 2 të mbledhjeve të datës 7 nëntor 2018.
2. Seancë dëgjimore me anëtarin e AMA-s, z. Zylyftar Bregu, në kuadër të shqyrtimit të kërkesës së Kryetarit të AMA-s, për fillimin e procedurave për lirim nga detyra si anëtar i AMA-s.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Bujar Çela, Adelin Rista, Almira Xhembulla dhe Ilir Beqaj (zëvendësues).

Mungojnë:

Fatmir Velaj, Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Nora Malaj, Kejdi Mehmetaj, Sezai Rrokaj.

Të ftuar:

Zylyftar Bregu - anëtar i AMA-s,

Arben Prifti – avokati mbrojtës (i paftuar nga komisioni).

Andi Balla – përfaqësues nga OSBE.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi - Mirëdita!

Zoti Bregu, mirë se keni ardhur!

Zhvillojmë sot këtë dëgjese të kërkuar nga ne, pasi në komisionin tonë janë depozituar disa informacione, për të cilat ju kemi vënë në dijeni edhe në takimet paraprake, lidhur me një konflikt interesi në kundërshtim me ligjin nr. 9367, për të cilin kërkuam një sqarim nga ju.

Në thirrjen e kaluar për datën 20 nëntor, ju ishit i pamundur fizikisht dhe kërkuat ta shtynit për në një moment të dytë, derisa të gëzonit shëndet të plotë.

Do t'ju lutesha që, kur ta shikoni të arsyeshme, të paraqisni në sekretarinë e komisionit justifikimin për herën e shkuar.

Fidel Ylli – Kourumi është i plotë. Ne mund ta vazhdojmë dëgjesën, por unë ndjej keqardhje për opozitën, kryesisht për anëtarin e LSI-së, që kërkoi në parlament të bënte një seancë dëgjimore. Gjithsesi, ne të vazhdojmë procedurat normale parlamentare.

Milva Ekonomi- Po, zoti Bregu.

A doni ta përsërisim edhe një herë çfarë u tha në takimin e parë?

Zylyftar Bregu- Jo, nuk është e rëndësishme, por unë po ju informoj që kam ardhur me avokatin mbrojtës, për të qenë më në rregull në mbrojtjen time.

Milva Ekonomi - Në fakt, takimin e kemi me ju, kështu që do të donim t'ju dëgjonim ju.

Zylyftar Bregu – Unë do të bëj një hyrje, pastaj aspektin juridik do t'ia lë avokatit mbrojtës ta bëjë, sepse është ai që e njeh më mirë aspektin procedural ligjor.

Milva Ekonomi- Ne ju kemi thirrur këtu, sepse në një medie CN.al është publikuar një kontratë juaja për marrjen me qira të një sipërfaqeje toke në fshatin Picar, prej 4,82 hektarësh. Kjo kontratë është nënshkruar në vitin 2015. Për këtë gjë jemi vënë në dijeni nga Autoriteti ku ju ushtroni detyrën, AMA, që ka njoftuar Kuvendin, i cili ka bërë verifikimet paraprake, ka çuar një informacion në Ministrinë e Bujqësisë, ka kontrolluar regjistrin e QKB-së. Kemi disa informacione në një dosje, të cilat iu çuan edhe juve për dijeni. Ajo që kërkojmë ne tani është konfirmimi për këtë situatë.

Zylyftar Bregu – Jam shumë dakord, prandaj jam këtu, por të drejtën e mbrojtjes ia kam deleguar avokatit tim.

Milva Ekonomi - Ne ju kërkojmë të na i shpjegoni ju.

Arben Prifti – Më falni, unë nuk jam legjitimuar akoma.

Milva Ekonomi- Ndërkohë, nuk keni njoftuar në komision që do të vini me avokatin. Ne duhej të kishim marrë informacion paraprakisht.

Arben Prifti – Më falni, unë nuk jam legjitimuar ende, nëse duhet të legjitimohem nga ana e zëvendëskryetares së Komisionit të Medies, megjithatë pres të më jepet fjala, nëse do të më jepet.

Milva Ekonomi- Unë do t’ju sugjeroja që të bëni një kërkesë tani, që ju përfaqësoheni nga avokati mbrojtës dhe ta depozitoni në sekretari.

Duhet të kuptoni që procedurat janë të rëndësishme në këtë proces. Procedura e njoftimit që ju do të jeni këtu, është e rëndësishme dhe avokati natyrisht që duhet t’ju kishte informuar për këtë gjë, sepse për procedurë po flasim.

Bujar Çela – Më falni nëse do të më jepet e drejta të flasim për procedurë bazuar në Rregulloren e Kuvendit...

Milva Ekonomi- Për procedurë zotëria ka nevojë t’ju ketë, e vendos ai, por për procedurë ai duhet të njoftonte komisionin që ka thirrur edhe avokatin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për procedurë kam tre deputetë që duan të flasin: Bujarin, Fadilin dhe Musain.

Fadil Nasufi – Kryetare, të mos dalim nga objekti. Ne jemi në dëgjese, nuk jemi në gjyq. Të konsultohet me avokatin, është puna e tij, por ne jemi në dëgjese. Të na shpjegojë arsyen, për të cilën jemi mbledhur.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kam të njëjtën logjikë, sepse anëtari i AMA-s zgjidhet nga Kuvendi; ne nuk jemi në gjykatë.

Milva Ekonomi -Do të konsultohemi, sepse jemi para faktit.

Musa Ulqini- Sipas ligjit për mediat elektronike, në pikën 1, të nenit 9, ku bëhet fjalë për zgjedhjen e anëtarëve të AMA-s, thuhet: “Anëtarët e AMA-s zgjidhen nga Kuvendi për një periudhë 5-vjeçare me të drejtë zgjedhjeje vetëm një herë”. Në pikën 2, të nenit 12, ku flitet për lirim nga detyra, sepse institucioni që e zgjedh ka të drejtë edhe ta lirojë nga detyra, thuhet: “Lirimi nga detyra i një anëtari të AMA-s mund të kërkohet nga Komisioni i Edukimit dhe Mjeteve

të Informimit Publik ose nga jo më pak se 5 anëtarë të AMA-s. Kuvendi e shqyrton kërkesën brenda 10 ditëve”.

Zonja kryetare, në pikën 3 thuhet se, para se të lirohet një anëtar i AMA-s, atij i jepet mundësia për të parashtruar mendimet e tij para komisionit. Pra, ne jemi në zbatim të nenit 12, pika 3. Kemi ftuar një anëtar të AMA-s për të bërë shpjegimet e tij, nuk kemi ftuar avokatin, ne nuk jemi organ gjyqësor. Ky institucion e zgjedh, ky institucion ka të drejtë ta kërkojë në dëgjese për çështje të caktuara, sipas tagrit që i ka dhënë ligji. Me avokat, sipas gjykimit tim, mund të shkojë në një institucion i cili merr masë, i vë gjobë, e çon për ndjekje penale.

(*Ndërprerje incizimi.*)

Milva Ekonomi- Unë do të propozoja që të na bëni një kërkesë me shkrim. Në fakt, kërkesën mund ta bëni edhe me gojë, sepse jeni këtu present; ka të njëjtën vlerë si edhe me shkrim. Na lini një kohë prej 3 minutash, që të marrim një vendim dhe do t’ju njoftojmë.

Ilir Beqaj - Për procedurë unë besoj se duhet të kemi edhe dëshminë që ju ushtroni profesionin e avokatit.

Njeriu vjen e thotë që unë përfaqësohem nga filan avokat, i cili ka këtë dokument dhe është anëtar i Dhomës së Avokatëve.

Arben Prifti- Faleminderit!

Unë, natyrisht, si avokat nuk mund të vij pa dëshminë e avokatit, por nuk është kjo. Duhet të keni parasysh se sjell në vëmendje të këtij komisioni të nderuar që gjithçka që ka të bëjë me këtë procedurë mbështetet në Kodin e Procedurës Administrative. Nuk kemi të bëjmë me gjykatë, por kemi të bëjmë me një organ qendror, i cili trajton një çështje.

Milva Ekonomi- Ju nuk e keni bërë kërkesën, jua thamë në fillim. Po të ishte për Kod Procedure, jua thamë që në fillim, ju duhej të kishit depozituar që në mëngjes një kërkesë për këtë dëgjese, që zoti Bregu të shoqërohej nga ju, bashkë me dëshminë tuaj të profesionit. Kështu edhe ju nuk e keni respektuar procedurën para një rasti si ky. Na lini kohë të marrim një vendim.

Ilir Beqaj - Edhe pse ne do të mblihdemi veçmas, vërtet ka një Kod Procedure, por aty ka një nen të veçantë, ku thuhet se këto rregulla zbatohen nëse në ligjin specifik nuk ka rregulla specifike. Kolegu Ulqini lexoi rregullat specifike që ka ky ligj.

Milva Ekonomi - Na jepni kohën që komisioni të konsultohet.

Ju lutem, prisni, se ne për shumë pak minuta do t’ju njoftojmë për vendimin.

Faleminderit!

(Komisioni konsultohet)

(Rifillon mbledhja)

Milva Ekonomi - Komisioni e shqyrtoi rastin tuaj. Ne do të donim që ju të na prezantonit avokatin mbrojtës dhe do të donim që avokati të depozitonte në sekretari kartën e profesionit. Ndërkohë ne vazhdojmë dëgjesën.

Zoti Bregu, fjala për ju. Ju lutem, prezantoni avokatin dhe të depozitohet karta.

Zylyftar Bregu – Faleminderit!

Të nderuar deputetë, më lejoni të them diçka për veten dhe çfarë mendoj unë për rastin!

Milva Ekonomi- Ju nuk keni bërë kërkesë me shkrim, ne po e tejkalojmë këtë gjë, por na duhet një konfirmim juaji për avokatin.

Zylyftar Bregu – Unë kërkoj që të jem në këtë komision bashkë me avokatin Arben Prifti, i cili do të më asistojë për aspektin juridik.

Milva Ekonomi- Po, vazhdoni të na sqaroni çështjen, për të cilën ju kemi kërkuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

...do t'ju lutesha, për procedurë përsëri, sepse Kuvendi është vënë në lëvizje nga një kërkesë e anëtarit të AMA-s..., pra, Kuvendi është vënë në lëvizje dhe jo komisioni. Të lutem, për procedurë.

Arben Prifti – Kuvendi është vënë në lëvizje pikërisht nga kryetari i AMA-s. Kuvendi më pas e delegon te komisioni dhe ky i fundit, konform ligjit dhe Rregullores, ka kërkuar dëgjesën. Kur kërkon dëgjesën, do të thotë se ka filluar procedurën administrative. Në rastin konkret, deri sa kërkesa është pranuar për t'u trajtuar, do të thotë se ndodhemi para trajtimit administrativ. Kjo gjë do të thotë se jo vetëm duhet të thirret pala, e cila, sipas kërkesës, ndodhet në konflikt interesi, por së pari, duhet të thirret edhe ai që e ka iniciuar, që ka vënë në lëvizje Kuvendin, pra duhen të dyja palët. Kodi i Procedurës Administrative e jep këtë të drejtë, me qëllim që të dëgjohet ai që e ka kërkuar dhe pastaj....

(Mungesë incizimi.)

Milva Ekonomi – Kemi autoritetin që emëron zotin Bregu në atë detyrë që ka. Komisioni i Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik është autoriteti. Depozitimi që është bërë në Kuvend nga ana e drejtuesit të AMA-s, është depozitim mbi një bazë informacioni të bërë publik në një

gazetë. Këtë ka depozituar në Kuvend. Ky i fundit ka marrë përsipër verifikimin e këtij informacioni dhe nga ky verifikim, ka dalë se informacioni që ka gazeta është i vërtetë. Ndërkohë, ne duam të dëgjojmë nga ju se si e shihni këtë gjë.

Ne jemi ata që emërojmë apo ç'emërojmë nga detyra.

Arben Prifti – Këtë pretendojmë edhe ne nga pikëpamja procedurale, që ka shkelje të ligjit nga ana e kryetarit të AMA-s, për faktin se nuk e ka të drejtën për t'i kërkuar lirimin nga detyra të një anëtarit, por ka të drejtë të informojë Kuvendin më parë.

Milva Ekonomi – E ka informuar Kuvendin, sepse opinionin e tij e ka sjellë në formë shkresore. Siç na e ka sjellë opinionin me shkrim për të gjithë çështjen, këtë opinion me shkrim jua kemi dërguar edhe juve. Opinioni i AMA-s është sjellë me shkrim në Kuvend dhe kjo është arsyeja që ju kemi thirrur të dëgjojmë opinionin tuaj lidhur me këtë çështje.

Zylyftar Bregu - Të nderuar deputetë,

Nuk është opinioni i AMA-s! Unë sapo kam ardhur nga një mbledhje e bordit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, e cila në unanimitet të plotë, të pesë anëtarët e saj thanë që proceduralisht kryetari ka shkelur ligjin. Pra, kryetari nuk e ka kaluar në bord për ta votuar dhe marrë votat për këtë informacion. Lënda e shkresës së kryetarit është “Largim nga puna e anëtarit të AMA-s”, i cili nuk është informacion, është thjesht largim nga puna.

Milva Ekonomi – Ligji e autorizon kryetarin e AMA-s që të informojë Kuvendin. Kjo gjë ka ndodhur. Pika 5 e nenit 12 të ligjit “Kur konstatohet njëri nga rastet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, kryetari i AMA-s njofton me shkrim brenda 5 ditëve Kuvendin”. Kështu e kemi të cituar në nenin 12.

Arben Prifti – Po, zonja kryetare, për procedurë edhe një herë.

Para se të kalojmë te pika 5, e nenit 12, të ligjit për median, duhet të kemi parasysht dispozitën ligjore që ka të bëjë me nenin 2, e cila thotë: “Lirimi nga detyra i një anëtarit të AMA-s mund të kërkohej nga Komisioni i Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik dhe jo më pak se 5 anëtarë të AMA-s. Kuvendi e shqyrton këtë kërkesë brenda 10 ditëve”. Pra, të drejtën për të kërkuar lirimin e ka pikërisht...

Milva Ekonomi – Më fal, por nuk kemi ardhur akoma “në lirim”, por po themi se duhet të dëgjojmë zotin Bregu. Kemi seancë dëgjimore për këtë rast.

Arben Prifti – Pse ka nisur kjo procedurë, ju lutem?

Milva Ekonomi – Ka nisur për vërtetësinë e një fakti...

Arben Prifti – Jo, shikoni objektin e kërkesës, i cili thotë “lirim nga detyra”. Këtë kompetencë nuk e ka kryetari i AMA-s. E keni ju si kompetencë apo “jo më pak se 5 anëtarë të AMA-s”. Ndaj po themi për procedurë që nuk legjitimohet, aq më tepër që kryetari i AMA-s, në bazë të pikës 5, ka të drejtë të informojë nëse e vërteton në bazë të pikës 1, të ligjit për konflikt interesi, pra, në qoftë se ai ka vërtetuar që anëtari i AMA-s ndodhet në konflikt interesi, atëherë informon Kuvendin. Jeni ju pastaj që mund të inicioni, keni prerogativa të veproni, të hetoni etj..

Milva Ekonomi – Ndërkohë, mendoj se në këtë moment, ne si autoriteti që kemi të drejtën e liritimit dhe shkarkimit, kemi kërkuar që të dëgjojmë nëse kjo kërkesë që na ka ardhur nga AMA është e vërtetë apo jo. Nuk jemi ende në fazën që thoni ju, por në një fazë paraprake.

Do t’ju lutesha të na jepni një informacion për atë që ju kemi thirrur, për kontratën dhe nënshkrimin e saj. Do të na ndihmoni ta kuptojmë këtë rast?

Zylyftar Bregu – Të nderuar deputetë,

Sapo ju informova që mbledhja e bordit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, që mbaroi vetëm para pak minutash, 5 anëtarët e saj nga 6 që duhej të ishin, e thanë unanimisht që procedura e ndjekur nga kryetari është joligjore dhe Kuvendi është vënë në lëvizje me një procedurë joligjore. Lënda e shkresës është “largim nga puna e anëtarit të AMA-s” dhe nuk është informacion. Largimi nga puna e këtij anëtar duhet të vinte nëpërmjet bordit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Milva Ekonomi – Si avokat mbrojtës edhe ju duhet ta shikoni në kornizën e ligjit, sepse edhe këtu po shihet në kornizën e ligjit. Kemi një rast, ku ne, si komision emërues, duam të shikojmë nëse ka konflikt interesi apo jo. Duke u marrë me “ka të drejtë komisioni, ka të drejtë AMA të kërkojë lirin nga detyra”, kjo është e barazvlefshme me ligj, sepse është “ose, ose”. Në këtë rast e kemi edhe ne këtë tagër. Ajo që po kërkojmë është ta zhvillojmë siç duhet detyrën tonë. Ndaj ju kemi thirrur në dëgjese.

Arben Prifti - Jam dakord, e nderuar zonja zëvendëskryetare, por kini parasysh edhe një herë si viheni ju në lëvizje, se proceduralisht nuk e keni iniciuar ju këtë dhe as 5 anëtarët që e kërkon ligji, por pikërisht ai që nuk legjitimohet ta iniciojë këtë. Pra, Kuvendin e ka vënë në lëvizje një subjekt, i cili nuk legjitimohet.

Milva Ekonomi - Nuk bie, sepse lajmi është bërë publik në media. Të drejtën e emërimit dhe shkarkimit të zotit Bregu e kanë ose 5 anëtarët, ose komisioni. Komisioni ka bërë kërkimet e

veta dhe kërkon nga ju që të shikojmë që pretendimet që keni, të na ndriçojnë në një mënyrë tjetër. Këtë dëgjesë po kërkojmë të bëjmë.

Zylyftar Bregu - Të nderuar deputetë,

Lajmi është bërë publik në media, por unë do të vërtetoj para jush dhe organeve ligjzbatuese që kryetari i Autoritetit të Mediave ka pasur dijeni për këtë kontratë që në muajin gusht të vitit 2016.

Nga ana tjetër, ju informoj se që në 31 mars të vitit 2016, e kam deklaruar në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit të Pasurive këtë kontratë publike. Pra, kryetari ka pasur dijeni, dhe e thashë se do ta vërtetoj para jush dhe organeve, që bërja e kësaj shkrese me objekt të gabuar dhe duke shkelur procedurën, duke mos e kaluar në bordin e AMA-s, është një shkelje e rëndë procedurale që ju ka vënë ju në lëvizje.

Ilir Beqaj - Faleminderit!

Para më shumë se një viti, në Kuvend dhe Këshillin e Legjislacionit kemi dëgjuar një prokuror që ka thënë: “Me çfarë është publikuar në media, kemi filluar një hetim”. Kështu që, indicie mund të marrim nga kushdo. Sot kemi një fakt, të cilin duam ta diskutojmë dhe më pas ta konfirmojmë. Ka një kontratë se si është lidhur ajo, është çështje e atyre që e kanë lidhur atë. Në qoftë se dikush ka pasur dijeni që ajo kontratë prodhonte konflikt dhe e ka mbajtur të fshehtë, është çështje e atij që e ka mbajtur. E ka ditur, nuk ka dashur ta tregojë, është ai që do të mbajë përgjegjësi për mostregimin. Në momentin që ajo shkresë, edhe nëse është nisur në mënyrë jo procedurale, përmban një fakt që është njohur botërisht që nga mediat, komisioni merr këtë fakt dhe do të arrijë në gjykimin e vetë nëse është apo jo i vërtetë. Këtu nuk po votojmë një shkresë të ardhur nga kryetari i AMA-s, me apo pa procedurë. Duam të bëjmë një dëgjesë për atë kontratë...

(Mungesë incizimi.)

Kështu që sot mendoj të vijojmë me atë që kemi shqetësim, thelbin e këtij problemi. Më pas, nëse zotëria i ftuar, do apo jo të përgjigjet, është çështja e tij.

Milva Ekonomi – Jam dakord me mendimin e Ilirit për këtë gjë. Duam të vazhdojmë me thelbin e kësaj çështjeje. Kjo është edhe arsyeja pse ju kemi thirrur. Ka një kontratë? A e shikoni veten në konflikt interesi? Si do të na e shpjegoni këtë gjë?

Arben Prifti - E nderuar zonja zëvendëskryetare,

Edhe një herë po përqendrohemi te procedura; jemi te procedura, e cila duhet të jetë e qartë edhe për këtë komision. Nuk bëhet fjalë për t’iu futur thelbit. Atij do t’i futemi, dhe aq më tepër

që do të na japë shpjegime qoftë personi, i cili pretendohet që është në konflikt interesi apo në ndalim të ligjit, por mbi të gjitha ajo që është kryesore, nëse duhet të fillojë apo jo ky procedim administrativ, aq më tepër kur nuk legjitimohet. Është tjetër gjë fakti publik, atëherë thoni që “po, komisioni ka marrë vendimin për të filluar një procedim administrative”, por ju jeni vënë në lëvizje nga kryetari i AMA-s.

Milva Ekonomi - Jemi vënë në lëvizje edhe nga një media që ka publikuar kontratën, përveçse na i ka sjellë kryetari i AMA-s. Ai është dokument i bërë publik në një gazetë.

Të lutem, për procedurë, ne kemi marrë kohën dhe të gjithë angazhimin për të dëgjuar deri në fund çfarë sqarimi do të na bëjë zoti Bregu për këtë gjë.

Para se të kalojmë në marrjen e vendimit, kemi këtu një kontratë, një verifikim të bërë nga Kuvendi dhe kërkojmë të shikojmë si qëndron puna për këtë çështje.

Arben Prifti - Nuk respektohet procedura...

Milva Ekonomi – Procedura është respektuar tamam!

Arben Prifti – Komisioni duhet të vepronte, por nuk e ka bërë!

Milva Ekonomi – Kuvendi i Shqipërisë është institucioni epror. Kur një anëtar është i zgjedhur në një nga entet, institucionet që janë kushtetuese dhe parlamentare, siç është rasti i AMA-s, duhet të vijë të respektojë të gjitha kërkesat që ka ligji për konfliktin e interesit, sepse është një person i zgjedhur në bord. Për këtë kemi nevojë të bëjmë një dëgjese. Dëgjesa bëhet për procedurë, të kemi të drejtën të informohemi për një rast të një anëtari që e kemi emëruar ne. Nuk do të marrim asnjë lloj vendimi, përveçse do të bëjmë dëgjesën. Ligji na jep të drejtën për ta bërë këtë dëgjese.

Arben Prifti -Ligji e jep këtë të drejtë, por komisioni, para se të bëjë dëgjesën, duhet të kryejë veprime.

Milva Ekonomi – Komisioni i ka kryer të gjitha veprimet dhe ka gjykuar që do të ketë një dëgjese, ndërkaq që ka vënë në dispozicion të zotit Bregu çdo informacion që kishte.

Arben Prifti - Ne e kemi këtë informacion, zonjë, kemi edhe informacionin tjetër, që ky komision është vënë në lëvizje nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, gjë që përsëri është në shkelje të Rregullores së Kuvendit. Pra, mund të themi se veprimet, për sa i përket informacionit, apo të hetojë në lidhje me kërkesën e kryetarit të AMA-s, nuk janë bërë nga komisioni, por nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, i cili është në shkelje të Rregullores së Kuvendit dhe në shkelje të ligjit.

Milva Ekonomi – Do të them edhe diçka, dhe më pas do t'ia jap fjalën zotit Bujar për të kaluar më pas në një diskutim tjetër.

Autoriteti i Mediave Audiovizive, zyra e kryetarit, i ka sjellë Kryetarit të Kuvendit njoftimin e gazetës dhe ka qenë ai që ka thënë të ndiqet çështja, të shikohet dhe merret informacion për këtë çështje. Ai nuk ka caktuar asnjë lloj forme procedimi. Ajo që jemi duke bërë është që po çojmë deri në fund detyrën tone për të marrë informacion për rastin në fjalë. Do t'ju ftoja të jepnit përgjigje ndaj pyetjeve që ne ju bëjmë.

Bujar Çela – Kisha diçka thjesht për procedurë. Ne jemi përballë dy gjërave: ose do të vazhdojmë dëgjuesën me zotin Bregu, ose zoti Bregu me gjithë avokatin të refuzojnë ardhjen në komision.

Milva Ekonomi – Po, Ilir!

Ilir Beqaj – Avokat, duhet të kesh diçka të qartë. Unë jam deputet dhe kam të drejtë të kërkoj informacion kudo dhe këtë informacion e dërgoj te sekretari i Përgjithshëm dhe, më pas, ai ia dërgon institucionit. Pra, unë bëj një kërkesë tek AMA, bëj një kërkesë te Bujqësia, te Shëndetësia dhe është sekretari i Përgjithshëm që e dërgon shkresën dhe po atij i vjen shkresa. Kjo është mënyra administrative se si funksionon, prandaj sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit është personi, i cili formalisht ka të drejtë të firmosë, vihet vula dhe shkon me korrespondencë. Pra, vetëm jep dhe merr...

Arben Prifti – Nuk jam kundër asaj që ju paraqitët, por pikërisht ajo që evidentohet është se ju nuk keni kërkuar asnjë informacion. Pra, komisioni nuk është vënë në lëvizje...

Milva Ekonomi – Ne nuk ju kemi thirrur ju këtu për të na dhënë informacion, ju lutem, mos e paragjykoni procesin që po ndodh. Ne ju kemi vënë në dispozicion gjithë dokumentet zyrtare, që është një kontratë e ardhur nga Ministria e Bujqësisë...

Arben Prifti – Ne po flasim për procedurën, jo për kontratën...

Milva Ekonomi – Ne po ju tregojmë që procedura është e pastër fare, është një procedurë administrative e qartë. Sekretari i Përgjithshëm bën një kërkesë...

Arben Prifti – Kompetencat tuaja si komision...

Milva Ekonomi – Nuk na i heq dhe as nuk na i shton askush kompetencat...

Arben Prifti – Unë po ngre si çështje që ju nuk keni vepruar si komision, prandaj kuptojeni thelbin...

(Diskutime pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Ne, si komision, kemi vepruar, prandaj po e thërrasim zotin Bregu dhe po si komision do ta bëjmë dëgjuesën. Pikërisht ajo që jemi duke bërë sot tregon se po veprojmë si komision.

Arben Prifti – Kryetari i AMA-s ju informoi edhe një herë që e ka dërguar shkresën me titull: “*Lënda: Largimi nga puna i anëtarit të AMA-s në kundërshtim me ligjin*”...

Nuk është informacion, por kërkesë për largim nga puna. E para.

Milva Ekonomi – Po të lexoni ligjin...

Arben Prifti – E dyta. Po ju them se 5 anëtarët e AMA-s sapo kanë përfunduar...

(Diskutime pa mikrofon.)

Arben Prifti – Çfarë thotë kërkesa?

Milva Ekonomi – Debati ka një kufi; nuk mund të vazhdoj pa fund me fjalët jo është e drejtë dhe nuk është e drejtë...

Arben Prifti – Më falni, ne nuk kemi ardhur për zhurmë këtu, por për procedurë...

Milva Ekonomi - Në qoftë se nuk jeni përgatitur për thelbin e çështjes, pasi e gjithë kjo këtë tregon, na sqaroni si doni të veprojmë. Mënyra se si ju po veproni, duke hedhur dhe pritur gjëra procedurale, nuk është fare e drejtë, pasi Kuvendi i ka respektuar të gjitha procedurat dhe tagrin që i jep ligji për rregullimin e marrëdhënieve me Autoritetin e Medieve Audiovizive, si dhe ligjin për procedurat administrative. Do t’ju lutesha shumë të përqendrohemi te çështja për të cilën kemi kërkuar këtë dëgjuesë, në mënyrë që të veprojmë më tej dhe të gjykojmë siç duhet, sepse me kaq informacion sa kemi, nuk na mundësohet një gjykim i plotë dhe për këtë arsye ju kemi thirrur ju për të gjykuar çështjen.

Fjalën e ka Ismeti.

Ismet Beqiraj – Më vjen keq, por prisja diçka tjetër, që seanca e dëgjimit të fillonte. Sikurse na e shpjeguat, në përputhje me kërkesat ligjore, me Rregulloren e veprimtarisë së Kuvendit dhe të komisioneve, por pa e paragjykuar avokatin, më vjen keq që ai nuk del dot nga tradita profesionale e avokaturës që bëhet në Shqipëri, duke e futur çështjen në ngërçin e procedurave. Këtu çdo gjë është e qartë, megjithëse këtë takim e kemi shtyrë disa herë, si dhe herën e fundit, ku u njoftuam 20 minuta më parë se personi nuk ishte në gjendje shëndetësore dhe për këtë arsye u detyruam ta anulonim mbledhjen.

E mbështes propozimin që bëri kolegu Çela, si dhe zonja Ekonomi, që në qoftë se ju nuk jeni të përgatitur për dëgjuesën e sotme lidhur me pyetjet që ne do t’ju bëjmë në komision, atëherë

ta diskutojmë dhe të marrim një vendim. Kjo është një procedurë, një zgjatim dhe një transplant i gjithë procedurave që bëhen kur gjyqet në Shqipëri shkojnë me nga 20 vjet. Pra, ky problem duhet parë dhe zoti Bregu, nuk ka pse të hezitojë, as avokati, që të na përgjigjen dhe t'i japin informacion komisionit. Mos të merremi me lojëra fjalësh “jo e keni ju si procedurë e jo e kanë ata”, pasi procedurat janë konform veprimtarisë parlamentare. Në të kundërt të procedojmë sipas vendimmarrjes dhe rregullores që ka vetë veprimtaria e komisionit.

Milva Ekonomi – Fjalën e ka zoti Ulqini.

Musa Ulqini – Kisha diçka për procedurë.

Kjo është Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë që rregullon aktivitetin tonë. Në nenin 36, i cili titullohet “Seancat dëgjimore publike”, thuhet:

Pika 1: “Komisioni mund të organizojë seanca dëgjimore publike me anëtarë të Këshillit të Ministrave, përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore ose publike... Komisioni është i detyruar ta realizojë seancën dëgjimore, sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen, në rast se 1/3 e gjithë anëtarëve të komisionit e kërkon atë në mënyrë të motivuar me shkrim”.

Dhjetë prej nesh kemi rënë dakord për zhvillimin e kësaj seance dëgjimore, anëtarët e Këshillit të Ministrave janë të detyruar të vijnë këtu dhe askush nuk ka tagër ta pengojë mbledhjen, sepse komisioni është i detyruar ta realizojë seancën dëgjimore. Ne nuk jemi 1/3-a që e kërkojmë mbledhjen, por jemi 10 persona, më shumë se gjysma.

Zonja kryetare, ne jemi të detyruar ta respektojmë, sepse kjo është Bibla, kjo është procedura mbi të cilën ne ecim. Këtu thuhet shumë saktë “Seancë dëgjimore publike”. Kush thirret, në këtë rast është tamam personi sipas nenit në fjalë, komisioni është i detyruar ta realizojë seancën dëgjimore. Askush nuk ka tagër ta pengojë, sepse është urdhërore, kështu që jemi të detyruar ta zhvillojmë seancën dëgjimore, pastaj ato të tjerat janë shumë të qarta në ligj dhe ne kemi gjithë të drejtën e Zotit që, në rastin konkret, të ftojme personin në fjalë. Këtë e thotë shumë mirë neni 7, i ligjit organik, që organi që e ka zgjedhur, ai organ ka atë drejtë të marrë nismën për ta shkarkuar. E thotë në mënyrë shumë të qartë. Ku është shkelja këtu?

Ne jemi në zbatim të ligjit organik dhe të Rregullores. Kryetari, zëvendëskryetarët dhe çdo anëtar i AMA-s lirohen nga detyra nga organi që i zgjedh. Ne jemi organi që i kemi zgjedhur, në rastin konkret dhe janë pikat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d” etj..

Pika “ç” thotë se vërtetohet se janë shkelur detyrimet e nenit 7 të këtij ligji dhe neni 7 flet për konfliktin e interesit.

Ne jemi duke bërë një seancë dëgjimore, për të parë se si është kjo çështje, sepse kemi indicie, kemi fakte, kemi prova për këtë gjë. Ku është gabimi këtu? Ku është shkelur procedura? Është tagri ynë. Ai zotëria është zgjedhur nga ne. Ne kemi të drejtë, mua s'më intereson fare nëse kanë gabuar apo s'kanë gabuar të gjitha institucionet e tjera, është në tagrin tonë. Ne e kemi propozuar, ne marrim iniciativën për ta shkarkuar, ne kemi të drejtë për ta liruar, ne kemi të drejtë të bëjmë seancë dëgjimore. Rregulloja e përcakton kur bëhet seanca dëgjimore. I plotësojmë kriteret sipas procedurës dhe komisioni është i detyruar të realizojë seancën dëgjimore, se jemi më shumë se 1/3-ta.

Milva Ekonomi – Urdhëroni!

Urdhëroni, zoti Fadil!

Fadil Nasufi – Në komisionin tonë kemi pasur raste, po marr rastin e asaj gazetares që pretendonte për shkarkim të padrejtë nga drejtori i RTSH-së, dhe e morëm këtu thjesht me lajm. Raste të tjera kemi nga mediat investigative, Stop-i apo Fiks-i, përsëri vendime që merren direkt nga të bërët publike. Mos të ngelemi te procedurat “kush e inicioi, si e inicioi”! A ka problem konkret që të sqarohemi? Në dëgjuesë jemi, pastaj institucionet e tjera që lëshojnë dokumentet, konfirmojnë konfliktin janë institucione që ndiqen dhe po të ketë një vendimmarrje të gabuar, kemi gjykatat dhe institucionet të tjera.

Ndaj ne s'duhet ta fusim në rreth vicioz këtë çështje, se s'dalim kurrë.

Arben Prifti – Të nderuar deputetë, anëtarë të këtij komisioni,

Edhe një herë ju bëj me dije se nuk kemi ardhur këtu për të penguar apo, qoftë, edhe për të dëgjuar nga ana juaj pikërisht atë që ka të bëjë me kërkesën. Ne këtu jemi të përgatitur edhe për sa i përket thelbit të procesit, pra ligjit material, në lidhje me faktin a ka apo nuk ka konflikt interesi, edhe për sa i përket asaj që është kryesorja, procedurës.

Unë e kuptova zotin Ulqini, i cili më tregoi dispozitën ligjore, që e keni këtë të drejtë. Kush e mohon këtë? Kush po e kundërshton këtë të drejtë për të emëruar apo për të?...

(Diskutime pa mikrofon.)

Milva Ekonomi - ... për të dëgjuar...

Arben Prifti – E drejta për të dëgjuar është një proces i rregullt ligjor, që është i përcaktuar në nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

E drejta për të dëgjuar ka të bëjë me të drejtën e kontradiktorialitetit. E drejta e debatit nuk është njëanshme, që të dëgjohej vetëm njëra palë, por të dëgjohej të dyja palët. Edhe pse kemi një proces administrativ, pra jo proces gjyqësor, flasim për një proces të rregullt.

(Diskutime pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Atëherë, a mundemi të vazhdojmë me dëgjesën, t’ju bëjmë disa pyetje, se këtë nuk e zgjidhim dot? Ne kemi të drejtën të vazhdojmë dëgjesën me ju, me palën tjetër apo me kë të duam ne, për sa kohë të sqarohemi plotësisht për të marrë një vendim të drejtë për rastin.

Ne po fillojmë një dëgjesë me ju.

Arben Prifti – Dakord, ne po e pranojmë, por dua të them se jeni në shkelje për sa i përket ligjit material dhe ligjit procedural, Kodit të Procedurës Administrative dhe sidomos dy ligjeve kryesore, që kanë të bëjnë me Autoritetin e Medieve Audiovizive, e cila ka të përcaktuar qartë në nenin 12 të saj, në lidhje me të drejtat që ka ky komision dhe aq më tepër për anën informale që ka kryetari i AMA-s për të informuar Kuvendin, në raste kur konstaton shkelje të pikës 1 të ligjit “Për konfliktin e interesit”.

Fidel Ylli – Zoti avokat, megjithëse kisha vendosur të mos flisja fare dhe t’i lija këta që janë juristë dhe specialistë të kësaj fushe, po ju bëj një pyetje.

Në rast se anëtarët e AMA-s janë të gjithë të korruptuar dhe me konflikte interesi, dhe nuk marrin një vendim në bord, si zgjidhet problemi, kur ka dalë në mes të sheshit, në media që ka një konflikt interesi dhe ne jemi institucioni që kemi tagrin e plotë, edhe pa anëtarin e AMA-s, edhe pa kryetarin, të bëjmë një seancë dëgjimore me gjithë këto institucione që varen nga ne dhe emërohen nga ne?

Arben Prifti – Nuk jam kundër dhe jam dakord me pyetjen që bëni.

Fidel Ylli – Po pse e zgjasim? Pse nuk jepni mbrojtjen, që ne të vazhdojmë me seancën dëgjimore?

Arben Prifti – Ju jeni vënë në lëvizje nga një kërkesë.

Fidel Ylli – Çfarë rëndësie ka kjo, kur është bërë fakt publik? Ka dalë në media. Edhe sikur mos të na e kishte sjellë kryetari kërkesën, ne merremi me dëgjesën...

(Diskutime pa mikrofon.)

Na e jep Kushtetuta këtë të drejtë, ne jemi institucioni nga ku varet AMA...

Hajde të vazhdojmë me seancën dëgjimore, jepni argumente...

(Diskutime pa mikrofon.)

Zylyftar Bregu – Të nderuar deputetë,

Unë jam zgjedhur në AMA në vitin 2010 dhe jam rizgjedhur në vitin 2016. Jam doktor i shkencave të Gazetarisë dhe Komunikimit. Jam i vetmi pedagog në AMA, që jam i punësuar në Universitetin Publik të Tiranës. Jam autor i parë i, të paktën, 4 teksteve dhe i dhjetëra artikujve shkencorë në fushën e gazetarisë.

Në vitin 2015 kam lidhur një kontratë publike me Ministrinë e Bujqësisë për marrjen e një sipërfaqeje toke prej 4,82 ha. Që në momentin e lidhjes së kësaj kontrate, e theksoj, publike, kam informuar ILKPDI-në, pra e kam deklaruar në çdo deklaratë vjetore këtë kontratë; gjithashtu, kam informuar kryetarin e AMA-s, me të cilin kam një dialog jo vetëm sy më sy, por edhe në telefon. Pra, kryetari i AMA-s është në dijeni që në vitin 2016 për këtë kontratë, për këtë sipërfaqe toke.

Jam konsultuar në rrugë informale me juristët e AMA-s, nëse jam në konflikt interesi apo jo dhe kam përgjigje që nuk jam në konflikt interesi.

Pjesën tjetër të sjelljes së kryetarit të AMA-s ju e dini tashmë, por po e ritheksoj që, pasi nisët ju procesin, unë bashkë me 1/3-ën e anëtarëve të AMA-s kërkuam mbledhje të jashtëzakonshme dhe kjo mbledhje u realizua sot në limitin e kufirit të lejuar nga ligji.

Sot, 5 anëtarë të AMA-s, nga 6 që jemi, përveç kryetarit, deklaruan se procedura e ndjekur nga kryetari është një procedurë joligjore, joetike, joadministrative dhe kjo procedurë e nisur nga kryetari është një precedent i rrezikshëm, që kryetari i AMA-s e bën përherë të parë në të gjithë jetën e AMA-s, një procedurë e rrezikshme që do ta cenojë secilin prej anëtarëve të AMA-s me togfjalëshin “konflikt interesi”.

Unë kaq desha të thosha dhe ia kaloj fjalën avokatit për të lexuar mbrojtjen që ka përgatitur.

Arben Prifti – Mbrojtjen ligjore e kam përgatitur edhe me shkrim, për të qenë korrekt në lidhje me bazueshmërinë ligjore në lidhje me kërkesën e kryetarit të AMA-s, me objekt “Lirimin nga detyra të anëtarit të AMA-s”, të përfaqësuar prej meje në këtë procedurë administrative...

(Diskutime pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Ne kemi një informacion publik. Për këtë informacion publik po kërkojmë dëgjese me zotin Bregu. Kërkojmë vetëm të na sqarojë për informacionin publik që kemi. Nuk është fare kjo kërkesë...

(Diskutime pa mikrofon.)

Arben Prifti – E nderuar zëvendëskryetare, lënda është “Kërkesë për librim nga puna”...

Milva Ekonomi – Po ne po i kthehemi nga e para gjithë historisë. Ne nuk po lirojmë nga detyra, edhe pse e kemi në detyrën tonë t’ju emërojmë e t’ju lirojmë nga detyra...

(Diskutime pa mikrofon.)

Arben Prifti – ...është fillimi i procedurës...

Milva Ekonomi - Më dëgjoni mua, se e mbaruam këtë çështje dhe po i rikthehemi prapë.

Ne kemi të drejtë të marrim informacion, meqenëse jemi autoriteti që e kemi detyrë kushtetuese të emërojmë dhe të shkarkojmë në bordet drejtuese të institucioneve, që janë institucione kushtetuese, anëtarët e bordit, kemi një indicie që na ka ardhur nga AMA, kemi një indicie nga një informacion publik për një kontratë me një ent publik për zotin Bregu. Kërkojmë të sqarohemi me zotin Bregu për këtë gjë. Ne kërkojmë të marrim informacion. Kaq.

Arben Prifti – Këtë po bëjmë, po ju sqarojmë...

Milva Ekonomi – Këtë bëni, por nëse hyjmë te procedura...

(Diskutime pa mikrofon.)

Procedura është e tëra në funksionin tonë, jua lexuam të tëra rregullat, nenet, kapitujt, geramat që kanë të bëjnë me ligjet që kornizojnë këtë veprimtari sot, që na jep të drejtën të marrim informacion për një çështje që është publike.

Ne do të dëgjojmë palët. Ju jeni një palë. Ju kemi thirrur në dëgjësë.

Ju lutem, vazhdoni e na jepni informacion!

E diskutuam dy herë këtë çështje. Ju lutem, mos iu ktheni më kësaj çështje!

Arben Prifti – E nderuar zonja zëvendëskryetare e komisionit,

Thelbi i gjithë çështjes këtu është te dokumentacioni që na keni vënë në dispozicion në lidhje me objektin për lirim nga detyra.

Bashkëngjitur janë të gjitha kontratat dhe verifikimet që keni bërë në lidhje me kontratën dhe nuk keni bërë atë që është kryesore, verifikimin në ILDKPI, nëse e ka bërë apo s’ka bazë konflikti...

(Diskutime pa mikrofon.)

Milva Ekonomi - Në bazë të ligjit 8537 “Për parandalimin e konfliktit të interesit”, neni 21, pika 1, ju keni të drejtë të na jepni një shpjegim për këtë çështje.

Dhe sa për dijeninë tuaj, edhe me institucionin e ILDKPI-së, ne kemi bërë një trajnim në dy faza, një fazë ishte publike, kurse faza e dytë ishte e drejtuar sipas komisioneve specifike, ku është bërë kjo pyetje. Në qoftë se një person që ka një detyrë të këtij lloji, siç jemi ne deputetët,

siç është një zëvendësministër, një ministër, një anëtar bordi, merr përsipër të nënshkruajë një kontratë me një ent publik, si quhet ky, ky është konflikt i hapur interesi dhe është sipas përcaktimit të nenit 21, pika 1, të këtij ligji që sapo përmenda.

Rasti është personal, ne po shikojmë qëllimin në këtë rast...

(Diskutime pa mikrofon.)

Arben Prifti – është më se e vërtetë, por ai është trajnim dhe nuk është ajo që ka të bëjë me thelbin dhe bazueshmërinë ligjore.

Më lejoni të jap shpjegime në lidhje me gjithë materialin e dërguar nga Komisioni i Medias.

E nderuar zonja zëvendëskryetare,

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të zotit Zylyftar Bregu, me lejoni të parashtroj para këtij komisioni argumentet ligjore kundër fillimit nga ana juaj të procedurës për lirim nga detyra të përfaqësuesit në këtë dëgjese...

(Diskutime pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Po jo, pra, nuk lejojmë të shpreheni në këtë mënyrë, se nuk është kështu kërkesa. Kërkesa është dëgjese...

(Diskutime pa mikrofon.)

Arben Prifti – Është kërkesë për lirim nga detyra...

Milva Ekonomi – Po le ta ketë bërë kryetari i AMA-s, nuk ka lidhje fare! Ne po bëjmë një dëgjese.

(Diskutime pa mikrofon.)

Duam informacion që të marrim një vendim...

(Diskutime pa mikrofon.)

Arben Prifti – Në e-mail-in e parë është shkruar “Dëgjese për lirim nga detyra”...

(Diskutime pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Ju japim kohën ta lexoni ...

Do t’ju lutesha që të bëni një kthesë, se kthesa që ju kërkojmë të bëni është që të kuptoni se ne po zhvillojmë një dëgjese.

Sipas indicies që kemi, na jepni të drejtën të marrim informacionin që duhet, për të marrë vendimin tonë...

(Diskutime pa mikrofon.)

Arben Prifti – Dëgjoni dhe vlerësoni!

Milva Ekonomi – Atë do të bëjmë, do të dëgjojmë.

Arben Prifti – Kuadri ligjor. Kuadri dhe baza ligjore që duhen pasur parasysh dhe duhen respektuar nga palët në këtë procedim administrativ të filluar nga ky komision është: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, Kodi i Procedurës Administrative, ligji nr. 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, ligji nr. 9131, datë 10.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, ligji nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar”, “Kodi i sjelljes së anëtarit të AMA-s”, miratuar në vitin 2016, Rregullorja e Kuvendit dhe rregullorja e Autoritetit të Medieve Audiovizive.

Pasi jemi njohur me dokumentacionin e Komisionit parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, i dërguar me shkresën përcjellëse nr. 3403Prot., datë 14.11.2018, në adresë të anëtarit të AMA-s, zotit Zylyftar Bregu, po parashtrojmë argumentet dhe pretendimet tona ligjore kundër kërkesës së kryetarit të Autoritetit të Medieve Audiovizive, me objekt kërkesë “lirim nga detyra”.

Për të pasur një mbrojtje të drejtë ligjore dhe efektive, po e trajtojmë atë në dy aspekte: në aspektin procedural dhe në aspektin material të ligjit.

Kërkesa e kryetarit të Autoritetit të Medieve Audiovizive, me nr.4392Prot., datë 01.11.2018, drejtuar Kuvendit, me objekt kërkesë “lirim nga detyra”, është arbitrare, jo e drejtë, jo legjitime dhe e pabazuar në prova dhe në ligj.

Para se të argumentojmë në mënyrë ligjore nëse i përfaqësuari, zoti Zylyftar Bregu, ndodhet në konflikt interesi me detyrën që ushtron si anëtar i AMA-s, i zgjedhur nga Kuvendi, kemi të drejtën që mbi kërkesën e sipërcituar, me anën e së cilës është vënë në lëvizje ky komision, të shtrojmë pyetjen nëse legjitimohet në këtë rast kryetari i AMA-s t’i drejtohet me kërkesë Kuvendit për të liruar nga detyra anëtarin e saj. Përgjigjen e kësaj pyetjeje, nga pikëpamja e bazueshmërisë ligjore, e gjejmë në nenin 12, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, me emërimin “Lirimi nga detyra”. Në këtë dispozitë, përveç të tjerash, përcaktohet: “1. Kryetari, zëvendëskryetari dhe çdo anëtar i AMA-s lirohet nga detyra nga organi që e ka zgjedhur atë kur: ç) vërtetohet se janë shkelur detyrimet e nenit 7 të këtij ligji. 2. Lirimi nga detyra i një anëtarit të AMA-s mund të kërkojë nga Komisioni për Edukimin

dhe Mjetet e Informimit Publik ose nga jo më pak se pesë anëtarë të AMA-s. Kuvendi e shqyrton kërkesën brenda dhjetë ditëve.

Para se të lirohet një anëtar i AMA-s, atij i jepet mundësia për të parashtruar pretendimet e tij para Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Vendimi për të liruar një anëtar ose më shumë se një anëtar duhet të jetë i bazuar në ligj dhe i arsyetuar për shkaqet që çojnë në lirimin e tij.

Vendimi i Kuvendit publikohet.

5. Kur konstatohet njëri nga rastet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, kryetari i AMA-s njofton me shkrim brenda pesë ditëve Kuvendin”.

Nga përmbajtja e kësaj dispozite, e cila është shprehur mjaft qartë, konstatojmë dhe kuptojmë drejt se kompetencën juridiksionale dhe atë lëndore për të kërkuar lirimin nga detyra të anëtarit të AMA-s e kanë dy subjekte të së drejtës procedurale administrative: nga njëra anë, është Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik pranë Kuvendit të Shqipërisë dhe, nga ana tjetër, është shumica e cilësuar e anëtarëve të AMA-s, e përbërë nga jo më pak se pesë anëtarë. Në këtë kuptim, kërkesa e çdo subjekti që merr prerogativa apo të drejta që nuk i takojnë me ligj, për më tepër kur janë kompetencë e një organi apo subjekti tjetër procedural, duhet të konsiderohet absolutisht e pavlefshme, ilegjitime dhe nuk mund të sjellë asnjë pasojë juridike. Për më tepër, edhe veprimet e iniciuara nga ky komision janë të pavlefshme, pasi është vënë në lëvizje dhe është rrjedhojë e një mjeti juridik të pavlefshëm: kërkesa e kryetarit të AMA-s për lirimin nga detyra të një anëtari të saj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në kuptim të nenit 41...

Më lejoni të mbaroj dhe pastaj vlerësojeni.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në kuptim të nenit 41 të Kodit të Procedurës Administrative, procedura administrative fillon kryesisht ose me kërkesë të palës së interesuar. Në rastin me objekt shqyrtimi, kjo procedurë ka filluar me kërkesën e kryetarit të AMA-s drejtuar këtij komisioni me objekt kërkesë “lirim nga detyra”.

Në kuptim të nenit 44 të Kodit të Procedurës Administrative, komisioni ka detyrimin të marrë të gjitha masat e nevojshme për përgatitjen sa më mirë të çështjes. Sipas pikës 2 të kësaj

dispozite, ky organ shqyrton përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si: kompetencën e organit publik të AMA-s, legjitimitimin, afatin, formën dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji.

Në përfundim të veprimeve të mësipërme, komisioni njofton palën kërkuese me shkrim që kërkesa është pranuar për vazhdimin e procedurës. Ai njofton palën kërkuese me shkrim për plotësimin e të metave lidhur me kriteret formale ligjore, duke caktuar një afat të arsyeshëm. Mosplotësimi i të metave brenda afatit të caktuar, përbën shkak për mospranimin e kërkesës.

Nga të gjitha këto veprime procedurale...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – E keni parë pikën 3 të nenit 12, që e citoni?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rregull.

Arben Prifti – A ma dhatë fjalën?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë e kam vënë, po nejse.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E diskutojmë.

Nga të gjitha këto veprime procedurale që parashikon ligji, nuk konstatohet asnjë veprim konkret i kryer nga komisioni për kërkesën e AMA-s, përkundrazi, kërkesa e këtij institucioni, me objekt “lirim nga detyra”, është konsideruar e rregullt dhe procedura administrative është konsideruar e filluar.

Në kuptim të neneve 65 dhe 66 të Kodit të Procedurës Administrative, komisioni duhet të kryente verifikimin për legjitimitimin e palës kërkuese dhe ta shqyrtonte paraprakisht këtë kërkesë, duke kërkuar rregullimin e të metave të saj.

Për sa më sipër, veprimet e kryetarit të AMA-s, në raport me Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, janë në konflikt të hapur me ligjin dhe si të tilla duhet të konstatohen të pavlefshme, pasi nuk mund të sjellin asnjë pasojë juridike.

Në bazë të pikës 5, të nenit 12, të ligjit 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, kryetari i AMA-s ka të drejtë të njoftojë me shkrim brenda pesë ditëve Kuvendin, kur

konstatohet njëri nga rastet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, që në rastin objekt shqyrtimi lidhet me germën “ç”, e cila kërkon të vërtetohet se janë shkelur detyrimet e nenit 7 të këtij ligji.

Në kuptim të kësaj dispozite konstatohet se kryetari i AMA-s ka të drejtë të njoftojë me shkrim Kuvendin, vetëm kur ka vërtetuar se janë shkelur detyrimet e nenit 7 të ligjit të sipërcituar. Në lidhje me këtë të drejtë shtrojmë pyetjen: a ka pasur ose jo dijeni kryetari i AMA-s për kontratën e qirasë, datë 02.07.2005, të lidhur mes anëtarit Zylyftar Bregu, si qiramarrës, dhe Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, si qiradhënës, kontratë e bazuar në ligjin e posaçëm nr. 8318/1998 “Për dhënien e tokave bujqësore me qira”? Nëse po, kur dhe në cilën periudhë kohore ka marrë ose ka pasur dijeni kryetari i AMA-s? A ka kërkuar kryetari i AMA-s, në bazë edhe të zbatimit të ligjit, të kryhen veprime hetimore për rastin në fjalë, me qëllim që të vërtetohet nëse janë shkelur ose jo detyrimet e nenit 7 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar””?

Nga aktet e vëna në dispozicion nga sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, me anë të shkresës nr. 3403/6, datë 14.11.2018, konstatohet se kryetari i AMA-s, zoti Gentian Sala, i është drejtuar Kryetarit të Kuvendit me kërkesën me shkrim nr. 4392Prot., datë 01.11.2018 për lirimin nga detyra të anëtarit të këtij institucioni, zotit Zylyftar Bregu, pasi sipas tij ky anëtar është duke e ushtruar mandatin në kushtet e konfliktit të interesit. Në kuptim të nenit 82 të Kodit të Procedurës Administrative, barra e provës për faktet e pretenduara mbi kërkesën e palës bien mbi këtë palë.

Nga përmbajtja e kërkesës drejtuar komisionit parlamentar, konstatohet se kryetari i AMA-s ka arritur në këtë konkluzion, pasi ka marrë shkas nga disa shkrime të publikuara gjatë ditëve të fundit në mediet sociale lidhur me përfitimet e anëtarit të AMA-s, në lidhje kontratash me institucionet publike.

Duke cituar më tej pjesë nga përmbajtja e kësaj kontrate, konstatohet se, në mënyrë konkrete, referuar lajmeve të publikuara në faqen zyrtare www.sna.al, përkatësisht në datat 22.10.2018 dhe 29.10.2018, rezulton se anëtari i AMA-s, zoti Bregu, ka lidhur kontratë me Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, në datën 02.07.2015, me objekt “qiramarrje të tokës bujqësore në pronësi të shtetit, me afat 90-vjeçar”.

Në lidhje me faktet e sipërcituara, duam t’i bëjmë me dije komisionit se nuk është aspak i vërtetë fakti se kryetari i AMA-s nuk ka pasur dijeni më parë për lidhjen e kontratës së qirasë, datë 02.07.2015, të lidhur mes anëtarit të AMA-s Zylyftar Bregu, si qiramarrës, dhe Ministrisë së Bujqësisë, si qiradhënës. Pretendimin tonë se kryetari i AMA-s ka pasur dijeni për lidhjen e

kontratës së qirasë në fjalë, e provojmë, së pari, me deklaratimet dhe pohimet e vetë zotit Zylyftar Bregu, i cili, pas nënshkrimit të kësaj kontrate, ka kërkuar konsulencë juridike me juristin e AMA-s për të sqaruar pozitën e tij në lidhje me lindjen e marrëdhënies së re juridike, nëse është ose jo në kushtet e ndalimit të ligjit. Përgjigjja e dhënë nga juristi, pasi është konsultuar me të dyja ligjet bazë: atë nr. 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”” dhe atë nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, ka qenë e qartë dhe e prerë, se subjekti kontraktues, zoti Zylyftar Bregu, nuk ndodhet në kushtet e ndalimit të ligjit apo të konfliktit të interesit.

Pas kësaj përgjigjeje, ka qenë vetë zoti Bregu që ka vënë në dijeni kryetarin e AMA-s, në lidhje me nënshkrimin e kontratës së qirasë. Ky i fundit e ka uruar që t’i ecë gjithçka mbarë.

Për më shumë, faktin që kryetari i AMA-s ka pasur dijeni për kontratën e qirasë e provojmë me përmbajtjen e korrespondencës, që ai ka pasur me mesazhe dhe me foto në celular në rubrikën *WhatsApp* mes zotit Bregu dhe kryetarit të AMA-s në gusht 2016.

Nga të dhënat faktike që disponojmë, rezulton e provuar se kryetari i AMA-s ka shkëmbyer foto të pasurisë së paluajtshme e llojit tokë, pronë të blerë nga ai, ndërsa zoti Bregu i ka dërguar foto të pronës tokë ullishte të marrë me qira në Vorë. Prej përmbajtjes së korrespondencës mes kryetarit të AMA-s dhe anëtarit të saj, zotit Bregu, të shkëmbyer në celular në rubrikën *WhatsApp* në muajin gusht 2016, provojmë katërcipërisht e në mënyrë të qartë dhe të plotë se kryetari i AMA-s ka pasur dijeni 2 vjet më parë për kontratën e qirasë të lidhur më 2.7.2015.

Fakti që kryetari i AMA-s ka pasur dijeni 2 vjet më parë për kontratën e qirasë së tokës ullishte, tregon se ai vetë ka qenë i bindur që zoti Bregu nuk ka qenë në kushtet e ndalimit të ligjit apo në konflikt interesi. Në të kundërt, në cilësinë e titullarit të institucionit, ai duhej të urdhëronte institucionin përgjegjës që të merrte të gjitha masat për parandalimin e konfliktit të interesit në institucionin e AMA-s, si organ qendror i administratës publike. Për këtë qëllim ai duhej të kryente verifikim dhe hetim administrativ, lidhur me interesat private të zotit Bregu, të cilat mund të ishin shkak për lindjen e një konflikti interesi të mbledhura nga burimet e ligjshme.

Së dyti, në emër të institucionit të AMA-s, që e drejton, ai duhej të mblidhte të dhëna personale për zotin Bregu, kudo ku ato janë regjistruar në regjistrat publikë, të cilat lidhen me interesat private, që mund të krijojnë ose duket sikur krijojnë konflikt interesi me funksionin publik ose me detyrën që ushtron, si anëtar i AMA-s.

Së treti, mbi bazën e informacionit të grumbulluar, bazuar në ligjin nr. 9367 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar””, kryetari i AMA-s duhej të vlerësonte nëse rasti konkret përbën konflikt të interesave, duke analizuar rolin dhe kompetencat e zotit Bregu në procesin e vendimmarrës.

Së katërti, titullari i AMA-s duhej të verifikonte dhe të vlerësonte, nëse nga situata e konstatuar në kushtet e konfliktit të interesave, kanë ardhur apo jo pasoja të caktuara.

Së pesti, AMA duhej t’i komunikonte anëtarit të saj, zotit Bregu, të dhënat e mbledhura dhe shkeljet e konstatuara, duke i kërkuar këtij të fundit masat që duhej të merrte për të zgjidhur konfliktin sipas përcaktimeve të bëra në ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

Së fundi, në cilësinë e autoritetit përgjegjës së AMA-s, kryetari i AMA-s duhej të merrte masat disiplinore sipas rastit dhe duhej të raportonte rastin në ILDKPKI për ndjekje të mëtejshme.

Vetëm pasi kryetari i AMA-s të merrte veprimet e mësipërme, atëherë në bazë të nenit 12, pika 5, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë” dhe, vetëm nëse kishte vërtetuar se janë shkelur detyrimet e nenit 7 të këtij ligji, duhej të vinte në lëvizje dhe të njoftonte me shkrim brenda 5 ditëve Kuvendin.

Provë tjetër që anëtari i AMA-s nuk është në ndalim me ligjin apo konfliktin e interesit, është fakti që zoti Bregu ka qenë transparent në veprimet e tij, që lidhen me kontratën e qirasë së tokës. Ai e ka deklaruar këtë kontratë pranë institucionit të ILDKPKI-së në vitin 2016. Ky fakt provohet me deklaratën mbi të dhënat konfidenciale të kryera pranë ILDKPKI-së. Kemi si provë një kopje të deklarimit të bërë në vitin 2016.

Një tjetër provë e fortë që zoti Bregu nuk është në konflikt interesi në ushtrimin e detyrës publike që ai ushtron, janë të dhënat ose korrespondenca ndërmjet postës elektronike, që zoti Bregu ka pasur me zonjën Elda Dabulla, inspektore e ILDKPKI-së në periudhën shtator-tetor 2017, si pasojë e një hetimi të thelluar të kryer nga ana e këtij institucioni. Në përfundim të këtij hetimi ka rezultuar se ky institucion nuk ka arritur të konstatojë që zoti Bregu, në cilësinë e anëtarit të AMA-s, të ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave me detyrën publike, që vazhdon të ushtrojë. Në lidhje me këtë fakt, për të pasur një raport për hetimet e kryera dhe rezultatin përkatës të kryera nga inspektori në datën 15.11.2018, i jemi drejtuar me shkresë inspektorit të ILDKPKI-së, ku i kërkojmë të na vërë në dispozicion dokumentacionin mbi rezultatet e hetimit të kryer.

Në aspektin material të ligjit, kryetari i AMA-s pretendon se zoti Zylyftar Bregu, aktualisht në detyrën e anëtarit të AMA-s, ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave me funksionin e zyrtarit publik.

Në bazë të ligjit nr. 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar””, neni 7, “Papajtueshmëritë dhe konflikti i interesave”, thotë:

“1. Anëtarë të AMA-s nuk mund të jenë individët që:

a) janë anëtarë të partive dhe shoqatave politike, ...;

b) janë persona të lidhur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” ose që kanë në pronësi pjesë kapitali apo aksione të shoqërive tregtare, si dhe të drejta të tjera në fushën e transmetimeve audiovizive, reklamës, prodhimeve të përmbajtjes së transmetimeve audiovizive, rrjeteve të komunikimit elektronik apo persona të punësuar gjatë vitit të fundit, anëtarë të organeve drejtuese apo këshilluese të këtyre subjekteve apo të lidhur me ndonjë licencë me këto subjekte.

2. Anëtarët e AMA-s duhet të deklarojnë:

a) çdo interes apo lidhje me ndonjë subjekt të licencuar nga AMA;

b) çdo interes të mundshëm në ndonjë licencë, që AMA ka dhënë ose synon të japë, si dhe nuk mund të marrin pjesë në diskutimin apo vendimmarrjen e çështjeve të lidhura me këta interesa apo lidhje, që përbëjnë raste për skualifikim, sipas nenit 37 të Kodit të Procedurave Administrative.”

Në kuptim të pikës “b” të nenit 7 të sipërcituar, vëmë re se ky ligj na referon te ligji tjetër nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar””. Sipas nenit 3 të këtij ligji, jepet termi “konflikt i interesit”, si më poshtë: “Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij publike.”

Në këtë kuptim dhe në përmbajtjen e këtij termi, nuk rezulton asnjë fakt apo rrethanë, ku interesat private të anëtarit të AMA-s, zotit Bregu, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, që kanë të bëjnë me kontratën e qirasë së tokës ullishte, ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe të përgjegjësisë të tij publike në institucionin e AMA-s, që lidhen me ushtrimin e shërbimeve të transmetimit, aplikimet

për transmetimet numerike, dhënien e autorizimeve apo licencave përkatëse, duke përfshirë shërbimet e ofruara nga RTSH-ja, garantimin e konkurrencës dhe detyrat e tjera.

Është tepër absurde të mendosh se në rrethanat e sipërcituara, të përcaktuara nga ligji, interesat private të zotit Bregu, që kanë të bëjnë me tokën e marrë me qira, të lidhen dhe të ndikojnë sadopak në ushtrimin e përgjegjësisë së tij publike.

Gjithashtu, neni 3, pika 4 e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar”, përcakton se konflikti i interesit, i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, përfshin disa përkufizime të tjera, për lloje të ndryshme të shfaqjes së tij, si më poshtë:

- a) “konflikt faktik i interesit”...;
- b) “konflikt në dukje i interesit” ...;
- c) “konflikt i mundshëm i interesit”...;
- ç) “konflikt rast për rast i interesit”...;
- d) “konflikt i vazhdueshëm i interesit”.

Edhe në kuptim të termave të mësipërme, nuk rezulton e provuar në asnjë rast që interesat private të anëtarit të AMA-s, zotit Bregu, të ndikojnë apo të shkaktojnë në të ardhmen shfaqjen e konfliktit të interesit në raport me ushtrimin e detyrave dhe të përgjegjësisë së tij zyrtare.

Në seksionin 1 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, përcaktohen kufizimet e interesave private të zyrtarit për parandalimin e konfliktit të interesave rast pas rasti për çështje të veçanta.

Referimi në nenin 21, “Ndalimi i lidhjes së kontratave”, në të cilën kryetari i AMA-s ka bazuar kërkesën drejtuar komisionit për lirimin nga detyra të zotit Bregu, në lidhje edhe me nenet 30 dhe 31 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, është i gabuar dhe nuk është aspak në zbatim dhe në interpretim të drejtë të dispozitave të këtij ligji.

Në rastin konkret, në nenin 30 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, parashtrihen kufizimet ligjore për anëtarin e autoritetit rregullator në të cilin bën pjesë edhe anëtari i AMA-s, por në kuptim dhe në zbatim të kësaj dispozite, kufizimet e anëtarit të organit të Autoritet Rregullator kanë të bëjnë me sferën e juridiksionit ose të ndikimit të këtij Autoriteti, që do të thotë, me fushën e ushtrimit të detyrave apo përgjegjësisë publike.

Me përcaktimet e këtyre kufizimeve ligjvënësi nuk ka pasur parasysh kufizimet e çdo veprimtarie private, por, rast pas rasti, ai ka parashikuar kufizimin e atyre veprimtarive private që lidhen me sferën e juridiksionit ose të ndikimit të autoritetit, ku anëtar i organit të Autoritetit Rregullator ushtron funksionin apo përgjegjësitë e tij publike.

Në këtë kuptim, nëse aktiviteti privat, kontrata e qirasë së tokës, e anëtarit të AMA-s, zotit Zylyftar Bregu, do të ndikonte në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësi të tij publike, atëherë do të ndodheshim në rastin e ndalimit të ligjit apo të konfliktit të interesit.

Për sa argumentuam më sipër, kërkojmë nga ky komision që kërkesa e kryetarit të AMA-s, për shkak se është e pambështetur në prova dhe në ligj, të rrëzohet. Gjithashtu, të pushojë edhe procedura e nisur nga komisioni për faktin se ne provuam katërcipërisht me argumente dhe prova ligjore që nuk ndodhemi para konfliktit të interesit.

Faleminderit!

Milva Ekonomi - Ka pyetje nga kolegët?

Nuk ka.

Ju lutem që këtë dokument ta depozitoni në komision. Ne udhëhiqemi nga kushtetutshmëria dhe mënyra se si procedojnë ligjet në Republikën e Shqipërisë. Ne e kemi për detyrë të bëjmë dëgjesa me të gjithë ata njerëz që i konsiderojmë të rëndësishëm për të na dhënë informacion, institucione, individë, persona që kanë nevojë të mbështeten apo të trajtohen nga komisioni. Kemi vepruar në linjë të plotë me atë që na jep të drejtë Rregullorja e Kuvendit dhe çfarë na jep të drejtë i gjithë informacioni që posedon ky komision. Nuk ka pyetje nga komisioni për këtë dëgjese

Ju falenderojmë shumë! Mos harroni që ne veprojmë në konsideratë të ligjit të konfliktit të interesit, i cili ka shumë çështje për të cilat duhen argumente.

Faleminderit!

Ju lutem të dorëzoni edhe raportin mjekësor.

Zylyftar Bregu – A mundet që avokati të japë kopjen e tij të vulosur dhe jo këtë që lexoi, sepse ishte imja dhe e pavulosur?

Milva Ekonomi – Ne e kemi të incizuar, por është mirë që të kemi një kopje të firmosur.

Kopjen që ju mendoni se është më mirë për të na lënë, raportin tuaj mjekësor dhe certifikatën tuaj të profesionit.

Zylyftar Bregu – E depozitova.

Milva Ekonomi - Po jua kujtojmë edhe një herë.

Faleminderit shumë për kohën! Do t'ju njoftojmë për çdo vendim që do të marrim më tej.

Zylyftar Bregu – Faleminderit juve!

Milva Ekonomi – Unë mendoj se bëmë mirë që i dëgjuam.

Ju mund të largoheni, kurse ne do të konkludojmë, sepse do të operojmë pas këtij momenti.

Unë mendoj se ne vepruam sipas të gjithë të drejtës që na jep Rregullorja. Ashtu siç tha edhe Fadili, ne bëjmë dëgjesa për një mësuese apo një gazetar, për çfarë nuk kemi bërë dëgjesa, kështu që edhe kjo ishte një dëgjesë për një gjë shumë publike. Dëgjuam raportin që kishin përgatitur, këtu kemi bazën ligjore dhe të gjitha interpretimet e bazës ligjore, kështu që unë mendoj që t'i japim vetes pak kohë, në kuptimin që ta marrim dokumentin e shkruar, ta konsultojmë me zyrën e Shërbimit Juridik dhe Shërbimit të Monitorimit, në mënyrë që të japim përgjigje specifike për çështjen. Pasi të kuptojmë më shumë se si duhet t'i gjykojmë pretendimet që ata kishin dhe si duhet t'i justifikojnë nga pikëpamja ligjore, të mbledhemi për të marrë një vendim.

Dakord jeni?

Të bëhet një raport dhe pastaj do të marrim një vendim. Dakord jeni për këtë?

Për këtë gjë, si përherë, do të jemi në kontakt me Gazin dhe me Sonilën dhe do të vendosim për këtë dokument.

Unë mendoj se dëgjesa jonë u bë me qytetari të lartë.

Faleminderit shumë!

MBYLLET MBLEDHJA